



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

VENDIM

Nr. 21, datë 07.10.2021

MBI

**“MIRATIMIN E RREGULLORES TË FUNKSIONIMIT TË SEKTORIT MËSIMOR
DHE KURRIKULËS, INFORMIMIT TË STUDENTËVE, KËSHILLIMIT TË
KARRIERËS DHE ALUMNI NË UNIVERSITETIN E ARTEVE”**

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në Ligjin nr. 80/2015, për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Urdhrin e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 319, datë 13.09.2021 “Për miratimin e Statutit të Universitetit të Arteve”, pasi diskutoi rreth propozimit të rregullores të funksionimit të Sektorit Mësimor dhe Kurrikulës, Informimit të studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni në UART, përcjellë nga grupi i punës i ngritur me Urdhrin e Rektorit me nr. 150, datë 17.09.2021, me votim të hapur,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Rregullores të funksionimit të Sektorit Mësimor dhe Kurrikulës, Informimit të studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni në Universitetin e Arteve.
2. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe tek transparenca.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Najada HAMZAJ

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Artan PEQINI

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Prof. Arben LLOZI

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Asoc. Dorian ÇENE

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Asoc. Kastriot TUSHA

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Endri SINA

Prof. Asoc. Gjergj PREVAZI

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI

Dea SHUBLEKA (Studente FAB)

Sindi ZDRAVA (Studente FM)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE

UN

**RREGULLORE
E ZYRËS
MËSIMORE & KURRIKULËS,
INFORMIMIT TË STUDENTËVE,
KËSHILLIMIT TË KARRIERËS
DHE
ALUMNI**

Miratur me Vendim të Senatit Akademik Nr. 21 datë 07/10/2021





Neni 1 Baza ligjore

Në përputhje me Udhëzimin Nr. 27, datë 29.12.2017 “Për Strukturat e brendshme akademike dhe administrative në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë”, Zyra e Sektorit Mësimor & Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimi i Karrierës dhe ALUMNI, është një strukturë ndihmës akademike me karakter administrativ në nivel institucioni.

Neni 2 Qëllimi i Rregullores

Kjo Rregullore ka si qëllim ndjekjen me rigorozitet të zhvillimit të kurrikulave, të informimit të studentëve, karrierës së studentëve të diplomuar në UART, zbatimin dhe menaxhimin e mbarëvajtjes të procesit mësimor në përputhje me Vendimet e Këshillit të Ministrave, Urdhrat dhe Udhëzimet e Ministrisë së Arsimit Sporteve dhe Rinisë, Statutin e Universitetit të Arteve, Vendimet e Senatit akademik, Vendimet dhe Udhëzimet e Rektorit, në lidhje të ngushtë me Fakultetet, pjesë kryesore e UART.

Neni 3 Fusha e veprimit

Zyra Mësimore & Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Karrierës dhe Alumni, është në varësi direkt nga Zëvendës Rektori për anën mësimore, ndjek të gjitha problemet e lidhura me anën mësimore, kurrikulën dhe informimit dhe karrierës së studentëve. Zyra bashkëpunon ngushtë me Dekanët, Zëvendës Dekanët, Përgjegjësit e Njësive Bazë të fakulteteve për procesin mësimor në UART.

Neni 4 Përbërja e Zyrës

Zyra Mësimore & Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Karrierës dhe Alumni, përbëhet nga 3 (tre) anëtarë, 1 (një) Përgjegjës dhe 2 (dy) Specialistë, nga të cilët 1 (një) specialist për anën mësimore dhe Kurrikulën, 1 (një) specialist për Informimin dhe ndjekjen e karrierës të studentëve (ALUMNI).

Neni 5 Detyrat e Zyrës





Në lidhje të ngushtë me të gjitha njësitë përbërëse të UART, kjo zyrë zbaton detyrat si më poshtë:

1. Ndjekjen e të gjitha problemeve që lidhen me procesin mësimor dhe fushën akademike në Universitetin e Arteve në bashkëpunim të ngushtë me Zëvendës Rektorin për anën mësimore.
2. Ndjekjen dhe koordinimin e të gjitha problemeve që lidhen me Kurrikulën sipas përcaktimit ligjor dhe akteve nënligjore në fuqi.
3. Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë vepron sipas Rregullores së posaçme të kësaj Njësie të miratuar me Vendim Senati.
4. Ndjekjen, gjurmimin dhe nxitjen e marrëdhënieve të vazhdueshme me studentët aktualë dhe me studentët e diplomuar. Studentët e diplomuar të Universitetit të Arteve janë të gjithë artistë të mirëfilltë si dhe specialistë të lartë të fushës së mësuesisë sipas profilit në të cilin janë diplomuar. Kontributi i tyre në fushën e artit është i pazëvendësueshëm. Universiteti i Arteve është pjesë e rëndësishme e projektit GRADUA, projekt i cili do të mbështesë Universitetet Shqiptare duke implementuar një model të integruar të kërkesës bazuar në bazën e të dhënave të të diplomuarve nëpërmjet:
 - a) mbledhjes së të dhënave për performancën e të diplomuarve;
 - b) lehtësimin e bashkëpunimit midis institucioneve të arsimit të arsimit të lartë dhe biznesit;
 - c) lehtësimin e vendosjes së të diplomuarve në tregun e punës.

Mbështetur në këtë projekt, kjo ndjekje/gjurmim do të ndihmojë në:

- a) Organizimin e informacionit, duke mundësuar monitorim të vazhdueshëm dhe efektiv të sistemit të trajnimit dhe tregut të punës.
- b) Ndërlidhjen dhe parashikimin e aftësive të nevojshme në të ardhmen për të përshtatur të diplomuarit në më të mirën e mundshme me tregun e punës.
- c) Mbështetjen duke krijuar një model të përputhshmërisë së kërkesës bazuar në bazën e të dhënave të të diplomuarve nëpërmjet:
 - i. grumbullimit dhe analizimit të të dhënave për performancën e të diplomuarve dhe universiteteve, duke mundësuar lëshimin e dokumentacionit të besueshëm, të vazhdueshëm dhe të përditësuar për vlerësimin e sistemit të arsimit të lartë në mbështetje të procesit të reformave në vazhdim;
 - ii. lehtësimin të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë dhe botës së biznesit;
 - iii. lehtësimin të vendosjes së të diplomuarve në tregun e punës.
5. Shqyrton/vlerëson nga ana teknike programet e reja të studimit, ndryshimin e programeve ekzistuese, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe përgatitjen e dokumentacionit përkatës deri në zbatimin e tyre.
6. Përpunon projekt-politikat e kuotave dhe kriteret e pranimit në programet e ciklit të parë dhe ciklit të dytë të studimeve.





7. Ndjek dhe monitoron procesin e pranimeve në tre njësitë kryesore (fakultete) të UART, në përputhje me kuotat e miratuara dhe kriteret e pranimit të miratuara më parë nga Senati akademik i UART dhe të konfirmuara nga MASR.
8. Ndjek veprimtarinë operative (mësimore) që lidhet me ciklin e parë dhe ciklin e dytë të studimit.
9. Kontrollimin dhe respektimin e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi për:
 - a) Hartimin dhe Paraqitjen e Planeve dhe Programeve Mësimore të dy cikleve të studimit nga ana e 3 (tre) Fakulteteve të UART;
 - b) Ndryshimet në planet ekzistuese.
10. Rakordimin e të dhënave të Planeve Mësimore dhe Ngarkesës Mësimore të personelit akademik me kohë të plotë dhe atij me kohë të pjesshme.
11. Përpilimi i Strukturës Vjetore për procesin mësimor në fillim të çdo viti akademik në zbatim të urdhrit të MASR.
12. Evidentimi i çdo problematike të krijuar dhe monitorimi i zgjidhjeve rast pas rasti; kontrolli përfundimtar i tërë dokumentacionit të mbajtur nga Sekretaritet mësimore.
13. Ndjekjen e kontrollit të zbatimit në praktikë të planeve dhe programeve mësimore të miratuara dhe disiplinës së zbatimit të tyre.
14. Ndjekjen e rregullit dhe korrektesës së zhvillimit të proceseve të mësimit, praktikave, si dhe të mbajtjes së dokumentacionit përkatës të këtyre proceseve, në lidhje të ngushtë me Përgjegjësit e Njësive Bazë dhe Sekretaritet Mësimore të Fakulteteve të UART.
15. Verifikimin e ngarkesës mësimore në tre Fakultetet e Universitetit, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Evidentimin e problematikave, sugjerime organit epror mbi masa konkrete për të përballuar nevojat e procesit mësimor për burime njerëzore, ambiente, etj.
16. Përpunimin dhe raportimin e të dhënave për MASR, në lidhje me procesin mësimor, sipas formateve të përcaktuara për çdo vit akademik.
17. Kontrollin e evidencave të personelit akademik me kohë të plotë dhe atij të ftuar, në tre fakultetet e UART. Verifikimi i zërave:
 - a) Orë të planifikuara;
 - b) Orë të realizuara (në përfundim të procesit mësimor);
 - c) Orë mbi normë;
 - d) Orë të pagueshme.Verifikimi i realizimit të orëve mësimore kryhet në zbatim të Marrëveshjes paraprake të nënshkruar nga personeli akademik me kohë të plotë në fillim të vitit akademik me përgjegjësit e Njësive Bazë, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
18. Përpunimin dhe raportimin e të dhënave të marra nga ngarkesat mësimore të dërguara nga tre fakultetet për planifikimin e projekt-buxhetit për vitin akademik pasardhës:
 - a) Numri i stafit akademik me kohë të plotë dhe atij me kohë të pjesshme për çdo fakultet sipas kategorive, titujve dhe gradave shkencore.



- b) Numri i orëve mësimore (ngarkesën vjetore), (normën vjetore) të stafit akademik me kohë të plotë dhe atij me kohë të pjesshme për çdo fakultet, sipas kategorive titujve dhe gradave shkencore.
19. Monitorimin e procesit të pranimit të studentëve në UAR I për çdo vit akademik, për të dy ciklet e studimeve në varësi të Vendimeve/Udhëzimeve të Këshillit të Ministrave/MASR dhe Urdhrave dhe Udhëzimeve të Rektorit të UAR; verifikimin pranë sekretarive mësimore të respektimit të afateve të hedhjes së rezultateve sipas Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH); bashkëpunimin me zyrën e statistikave për respektimin e afateve të raportimit të të dhënave në MASR; ndjekjen e fazës përmbyllëse të të gjitha ndryshimeve dhe shtesave të kuotave.
20. Administrim dhe menaxhim të portalit U-Albania, në ndihmë të maturantëve, nëpërmjet seksionit specifik të portalit në bashkëpunim me IT e UAR.
21. Krijimin dhe përditësimin e arkivës së Sektorit Mësimor më të dhëna rreth personelit akademik të UAR:
 - a) kategoria e punës;
 - b) titulli akademik;
 - c) titullar lënde,
 - d) etj..
22. Verifikimin dhe përditësimin e informacionit rreth ndryshimeve në numër, kategori dhe tituj akademik të punonjësve mësimorë të brendshëm dhe të ftuar; në bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore & IS/P-A, Sektorin e Informacion/Statistikës dhe Drejtorinë Ekonomike dhe të Investimeve të UAR.
23. Shqyrtim ankesash apo kërkesash të ndryshme të paraqitura nga individë, grupe studentësh, apo pedagogësh në lidhje me probleme të veçanta të procesit mësimor.
24. Mban marrëdhënie të vazhdueshme me këshillat studentorë, drejton procesin e këshillimit të studentëve, mban komunikim me tregun e punës, si dhe ofron asistencë në orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve në fushën e artit dhe kulturës. Ajo drejton dhe mbështet në mënyrë të vazhdueshme Këshillin Studentor, i cili është një hallkë e rëndësishme në jetën studentore.
25. Jep informacione për programet, kurrikulat si dhe Diplomat që ofron UAR.
26. Përgatit guida dhe fletëpalosje orientuese për studentët e vitit të parë.
27. Me ndihmën e Sektorit të TI, bën kalimin e materialeve informuese në faqen e internetit, si njoftime për studentët, njoftime për aktivitete të ndryshme kulturore si konkurse, festivale filmi, ekspozita etj..
28. Informon për rregullat dhe dokumentacionin që duhet të sjellin për aplikim/regjistrim për programet e ciklit të parë Bachelor dhe ciklit të dytë Master.



29. Përditëson bazën e të dhënave të institucioneve me të cilat UART ka marrëveshje bashkëpunimi, të cilat kanë në fokus Karrierën dhe punësimin e ardhshëm të studentëve të UART.
30. Mban kontakte individuale me studentët edhe pas diplomimit e punësimit të tyre duke marrë në mënyrë të vazhdueshme feedback-un e tyre si dhe duke krijuar një database statistikash.
31. Rregullon dhe siguron përfshirjen e studentëve në vendimmarrje, në proceset e aktivitetet kryesore që lidhen me mësimdhënien dhe aktivitetet e tjera artistike zhvilluese në ambientet e UART dhe jashtë tij.
32. Konsulton studentët Diplomantë mbi mundësinë e regjistrimit në Platformën GRADUA, për të pasur qasje të lehtë në informacion mbi mundësitë e punësimit apo praktikës profesionale.
33. Hartim raportesh institucionale, me të dhëna që lidhen me veprimtarinë Mësimore & Kurikulave, ndjekjes së Karrierës së Studentëve, Sigurimit të Cilësisë për Rektorin e UART, për MASR, etj..
34. Të kontribuojë në politikat e zhvillimit të Universitetit të Arteve, në hapjen e drejtimeve të reja dhe përgjithësisht në proceset e reformimit eventual.
35. Raportimin në lidhje me procesin mësimor dhe zhvillimin e kurrikulave, Rektorit dhe Zëvendës Rektorit për anën mësimore të Universitetit të Arteve.
36. Respektimi i orarit të punës dhe gjithë elementëve të tjera të disiplinës në punë.
37. Zbatimi i çdo urdhri të posaçëm të Rektorit të UART, për situata të veçanta, urgjente e ngjarje të rëndësishme në jetën e institucionit.

Neni 6 Ndryshimi i Rregullores

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje bëhen në përputhje me përcaktimet në Statutin e UART.

Neni 7 Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit në Senatin Akademik të UART.

